



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.76

26 qershor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.338, datë 6.6.2007	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pasurive, toka pyjore publike, ku janë ndërtuar stacione bazë të transmetimeve të sinjaleve (BTS), nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Ministria e Brendshme.....	2291
Vendim i KM nr.339, datë 30.5.2007	Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Tashikistanit.....	2291
Vendim i KM nr.344, datë 6.6.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.....	2292
Vendim i KM nr.345, datë 6.6.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.832, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së administrimit të Qytetit-muze të Gjirokastrës”	2292
Vendim i KM nr.349, datë 6.6.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.564, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”	2293
Vendim i KM nr.350, datë 14.6.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes, për mbulimin e shpenzimeve, për dezinfektimin e zonave bregdetare, në kuadër të luftës kundër vektorëve	2294
Vendim i KM nr.351, datë 14.6.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	2299

Vendim i KM
nr.352, datë16.6.2007

Për lejimin e kalimit transit të disa trupave ushtarake italiane,
përmes territorit të Republikës së Shqipërisë..... 2300

Shpallje kërkesë për shpronësim, për interes publik, të pasurive të
paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit
rrugor unaza Shkodër..... 2300

VENDIM
Nr.338, datë 6.6.2007

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE, TOKA
PYJORE PUBLIKE, KU JANË NDËRTUAR STACIONE BAZË TË TRANSMETIMEVE TË
SINJALEVE (BTS), NGA MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE TE MINISTRIA E BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14, 15, shkronja “c”, e 16, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjitha tokat pyjore publike, ku janë ndërtuar, instaluar apo përshtatur stacione bazë të transmetimeve të sinjaleve (BTS), i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme.

2. Ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave te Ministria e Brendshme, sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për territorin funksional, ku është vendosur stacioni bazë, si dhe për mjediset e tjera ndihmëse të stacionit.

3. Marrëdhëniet e Ministrisë së Brendshme me personat e tretë, publikë apo privatë, që kanë ndërtuar ose kanë marrë me qira stacione, në tokat e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të rregullohen sipas dispozitave të Kodit Civil.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, që, brenda 20 ditësh, të përcaktojnë sipërfaqet e sakta, për efekt të pikës 2 të këtij vendimi.

5. Lista e tokave pyjore publike, sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, i dërgohet për zbatim kryeregjistruesit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

VENDIM
Nr.339, datë 30.5.2007

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E
TAXHIKISTANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Taxhikistanit.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.344, datë 6.6.2007

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË RREGULLOREN E ZBATIMIT TË KODIT
RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.153,
DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet ky ndryshim dhe kjo shtesë:

1. Pika 1 e nenit 60, riformulohet, si më poshtë vijon:

“1. Zonat e shërbimit, të caktuara për furnizimin ose për pushimin e përdoruesve të rrugës, janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme, për arritjen e qëllimeve të sipërpërmendura, me shpërndarës karburanti, ofiçina shërbimi (servise) dhe lavazhe, vende pushimi ose qëndrimi, mjedise shërbimi për udhëtarët, në nivel ose disnivel, kabina telefonike, pika të ndërhyrjes së shpejtë dhe të policisë rrugore, si dhe shërbime higjieno-sanitare, të përshtatshme.”.

1. Në pikën 4 të nenit 65, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Gjithashtu, duhet të jenë të aftë, që, në bazë të normave të sigurimit, të mbajnë njëkohësisht edhe disa mjedise shërbimi, brenda të njëjtit kalim.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.345, datë 6.6.2007

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.832, DATË 11.12.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË
ADMINISTRIMIT TË QYTETIT-MUZE TË GJIROKASTRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 29 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.832, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për miratimin e rregullores së administrimit të Qytetit – muze të Gjirokastrës, shpallur nga UNESCO-ja “Pasuri e Trashëgimisë Botërore”.”.

2. Në rregulloren, që i bashkëlidhet vendimit në fuqi, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

A) Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Qytetit – muze të Gjirokastrës

1. Për administrimin dhe menaxhimin e Qytetit-muze të Gjirokastrës krijohet, në këtë qytet, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Qytetit-muze (më tej ZAKGJ), si person juridik publik, në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Struktura dhe organika e Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Qytetit-muze të Gjirokastrës miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Drejtori i ZAKGJ-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

4. Marrëdhëniet juridike të punës, të drejtat dhe detyrimet, si dhe procedurat e rekrutimit të punonjësve të ZAKGJ-së mbështeten në Kodin e Punës dhe në dispozitat e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi.

5. Veprimtaria e ZAKGJ-së mbështetet në dispozitat e ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, në këtë vendim, aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi, si dhe në rekomandimet e UNESCO-s.

6. Rregullorja e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e specialistëve të ZAKGJ-së miratohen me urdhër të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.”.

B) Neni 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 14

ZAKGJ-ja bashkëpunon me organet e pushtetit, qendror dhe vendor, si dhe me UNESCO-n e organizatat e tjera ndërkombëtare etj., në bazë të marrëveshjeve të lidhura dhe në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare prej datës 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.349, datë 6.6.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.564, DATË 12.8.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR LICENCIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.564, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 4 të bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç. Deklaratë e drejtuesit të shërbimit, ku përcaktohen masa e financimit, burimi dhe kohëzgjatja e tij.”.

b) Shkronja “dh” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh. Vërtetimet nga organet e gjykatës dhe të prokurorisë, me anë të të cilave vërtetohet se drejtuesi dhe stafi i shërbimit nuk janë në ndjekje penale ose palë në një proces gjyqësor penal, dhe vërtetimin se subjekti nuk është në proces falimentimi. Këto vërtetime duhet të jenë lëshuar brenda

tremujorit të fundit, nga çasti i paraqitjes së kërkesës.”.

c) Në shkronjën “ë”, pas shprehjes “... Curriculum Vitae...” shtohen fjalët “... për drejtuesit dhe...”.

2. Në pikën 7 fjalët “... një herë në muaj...” zëvendësohen me “... një herë në dy muaj...”.

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Tarifa për pajisjen me licencë për ofruesit e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, vendas dhe të huaj, është 10 000 lekë. Tarifa e rinovimit të licencës është 5 000 lekë.”.

4. Në pikën 12 fjalët “... në pikën 3...” zëvendësohen me “... në pikën 4...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.350, datë 14.6.2007

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MINISTRINË E MBROJTJES, PËR MBULIMIN E
SHPENZIMEVE, PËR DEZINSEKTIMIN E ZONAVE BREGDETARE, NË KUADËR TË
LUFTËS KUNDËR VEKTORËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.7643, datë 2.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”, të ndryshuar dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kuadër të luftës kundër vektorëve, për përballimin e shpenzimeve për dezinfektimin e zonave bregdetare:

a) Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, artikulli “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 6 200 000 (gjashtë milionë e dyqind mijë) lekësh.

b) Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, artikulli “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 3 636 000 (tre milionë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekësh.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Dezinsektim						
I Me mjet fluturues						
Vijë bregdetare						
		Deltamethrine 2.5%			Vlera	
	Hektar	1L / për 2.5 Ha	Total Litra	Kosto per Ha	Kosto	
1 Velipoja	200.00	2.50	80.00	1,200.00	240,000.00	
2 Shengjin	250.00	2.50	100.00	1,200.00	300,000.00	
3 Tale	100.00	2.50	40.00	1,200.00	120,000.00	
4 Gjiri i Lalzit	150.00	2.50	60.00	1,200.00	180,000.00	
5 Spille - Karpan	150.00	2.50	60.00	1,200.00	180,000.00	
6 Divjakë	350.00	2.50	140.00	1,200.00	420,000.00	
7 Vlore	300.00	2.50	120.00	1,200.00	360,000.00	
Total 1	1,500.00		600.00		1,700,000.00	
II Dezinsektim në vatra						
		Deltamethrine			Vlera	
	Siperfaqe Ha	1L / për 2.5 Ha	Total Litra	Kosto per Ha	Kosto ne lek	
	2,500.00	2.50	1,000.00	1,800.00	4,500,000.00	
Total 2	2,500.00		1,000.00	1,800.00	4,500,000.00	
Totali 1 - 2	4,000.00		1,600.00		6,200,000.00	
III Kosto e mjetit fluturues						
	Ore Fluturimi		41.00			
	Kosto		3,636,000.00			
IV Total 1 - 2 - 3						
					Vlera	9,836,000.00

Të dhënat për koston e dezinfektimit të zonave bregdetare me avion AN-2

Nr.	Zonat e përpunimit	Sipërfaqja në Ha	Orë Fluturimi*	Kostua në lekë
1	Velipoja	200	4	240000
2	Shëngjin	250	5.5	330000
3	Tale	100	2	120000
4	Gjiri i Lalësit	150	3.5	210000
5	Spille, Karpën	150	5.5	330000
6	Divjaka	350	10.5	630000
7	Vlorë	300	4	240000
8	Inteneraret**		6	360000
	Shuma	1500	41	2 460 000

*Kostua për një orë fluturimi është 60 000 lekë.

** Intenereret e ribazimit të avionit AN-2 do të jenë Kuçovë, Rinas, Gjadër, Pishporo/Vlorë.

Kostua për 13 persona për 10 ditë do të jenë..... 500 000 lekë

Djetat e personelit për 10 ditë do të jenë 546 000 lekë

Shpenzime transporti..... 130 000 lekë

Shuma e përgjithëshme 3 636 000 lekë

Adresa e postës:
Tirane
Posta Postale
Posta 1100
Adresa e emailit:
info@pegasus.com



PEGASUS LTD
Pharmaceutical Storehouse

MESSAGE

No. (2007-001)

SHËNIMET PËR LUFTIMIN E MUSHKONJAVE DHE MIZAVENIE SPERKATJE ME
POMPE

To: SHËNIMET SHËNDETËSISE
Adresa: Durrës
cc:
Fax: 067 431 7037
Tel:

From: Janis Karathanos
Page: 1 out of 1
Date: 30th May 2007 (Wednesday)
Aim: Please Reply
Comment: -

PRODUKTI:

1. DELTAMETHRIN 2,5% OSE
2. LAMBA CYHALOTHRIN 2,5%

1. DELTAMETHRIN 2,5%

1 LITER DELTAMETHRIN 2,5% PER 2,5 HA
0,4 LITER DELTAMETHRIN 2,5% PER 1,0 HA

SASIA 0,4 LITER/HA x ÇMIMI 2000/LITER = 800 LEKE

SHËNIMET PËR TRASHITIMIN

1 HEKTAR ME POMPE SHËNIMET 1000 LEKE

VLERE PËR 1 HEKTAR = 1800 LEKE

SHËNIMET ENJEIT VLERE ENJEIT PËR TË SPËRKALIT ME LAMBA CYHALOTHRIN

Janis Karathanos



PEGASUS LTD
Pharmaceutical Storehouse

MESSAGE

No. (2007-002)

PROJOMIRË PËR LUTIMIN E MUSEKONJAVE E HEMIZAVE ME SPERKATJE ME

To:	SHËNDETËSISË	From:	Janis Karathanos
Atto:	Shërbimi Mbrojtjes	Page:	1 out of 1
cc:		Date:	31 th May 2007 (Wednesday)
Fax:	06-444337	Aka:	Please Reply
Tel:		Comment:	-

PRODUKTI:

1. DELTAMETHRIN 2,5% OSE
2. LAMBDA CYHALOTHRIN 2,5%

1. DELTAMETHRIN 2,5%

NË LITER DELTAMETHRIN 2,5% PËR 129 LITRA UË.

NË LITER TRETËSIRË PËR TË SPERKATUR 20M2 SUPERFAQE.

NË LITER DELTAMETHRIN 2,5% PËR TË SPERKATUR 2,5 HA SUPERFAQE.

KOSTUA: 1200 LITRA TRETËSIRË DELTAMETHRINE 2,5% PËR ÇDO HA SUPERFAQE E SPËRKATUR.

NE KETE LUMI JANË INKLUEDUAR

A PRODUKTI

B MAKINAT SHORER QËSE ME RESERVUARËT PËRKAPËS PËR PËRZJERJE.

SHENIMI DHË SPERKATJA ME LAMBDA CYHALOTHRIN KA TË NËNTE KOSTO.

Janis Karathanos

VENDIM
Nr.351, datë 14.6.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pikat 2, paragrafi i parë, e 3, dhe 83, të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalja e fundit, e paragrafit të dytë të pikës 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për shtetasit, të cilët hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, si dhe ata të cilët marrin vizë në kufi, kohëqëndrimi është 90 ditë për 180 ditë.”.

2. Në paragrafin e parë të pikës 10, togfjalëshi “... 90 ditë. . .” zëvendësohet me “... afati i përcaktuar në paragrafin e dytë të pikës 8...”.

3. Pikat 1 dhe 2 në lidhjen 8/1 “Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Shtetasit e huaj, me kombësi shqiptare, hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, pa vizë, për qëllime turistike, duke i paraqitur policisë kufitare çdo dokument të vlefshëm udhëtimi ose identifikimi.

Kjo pikë zbatohet për periudhën 1 maj — 31 tetor.

2. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, për qëllime turistike, hyjnë pa vizë shtetasit e shteteve të mëposhtme:

- Serbi;
- Bosnjë dhe Hercegovinë;
- Mali i Zi.”.

4. Në shtetet e përcaktuara në lidhjen 8 “Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë”, shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë me grupe turistike, të organizuara nëpërmjet agjencive turistike shqiptare, duke marrë në kufi vizë kolektive 72-orëshe, kundrejt pagesës.”.

5. Në lidhjen nr.8 “Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë”, të bëhen shtesat e mëposhtme:

“a) Në listën “Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë dhe pa pagesë (kur udhëtojnë me pasaporta diplomatike dhe shërbimi)”, të shtohen shtetet “Çekia, Estonia, Letonia, Lituania”.

b) Në listën “Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, duke paguar taksën e hyrjes (kur udhëtojnë me pasaportë të thjeshtë”, të shtohet shteti “Brazil”.”.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.352, datë 16.6.2007

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE ITALIANE,

PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 21 (njëzet e një) trupave dhe 13 (trembëdhjetë) mjeteve ushtarake italiane, në itinerarin Durrës - Qafë-Thanë, në datën 18 qershor 2007.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit kufitar, në Durrës, dhe pika e daljes është pika e kalimit kufitar, në Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në “Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave”, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951 dhe në “Marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të “Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Gjatë itinerarit të lëvizjes trupat italiane të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor unaza Shkodër.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët, që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë se në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar, për të gjithë pronarët, që janë bërë shënimet “Plotësim dokumentacioni”, “Proces regjistrimi”, “Pretendim pronësie”, paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë deri në momentin që do të paraqesin dokumentacionin respektiv të pronësisë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Rrethi Shkoder
Bashkia Shkoder

Lista e Pronareve qe shpronsohen per efekt te ndertimit te Unazes Shkoder.

Lloji I Pasurise Patundshme: Truall dhe objekte nr.(1-64)

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr.Parc	Z.Kadastrale	TRUALL			Vlera totale ne leke	Shenime
						Sip. (m2)	Cmimi L/m2	Vlefte ne leke		
1	Nimet		Shehu	13/122,13/120	8591	60	4500	270000	270000	Plotësim dokumentacioni
2	Beqir		Kraja	13/119	8591	90	4500	405000	405000	Proçes rregjistrimi
3	Berhan		Zerdelia	13/118	8591	87	4500	391500	391500	Proçes rregjistrimi
4	Ardir		Shkreli	13/9	8591	33	4500	148500	148500	Proçes rregjistrimi
5	Selaudin		Zerdelia	13/10	8591	66	4500	297000	297000	Proçes rregjistrimi
6	Perlat		Zoga	13/6	8591	117	4500	526500	526500	Proçes rregjistrimi
7	Ahmet		Osja	13/15	8591	4	4500	18000	18000	Plotësim dokumentacioni
8	Ahmet		Osja	13/3	8591	28	4500	126000	126000	Plotësim dokumentacioni
9	I paidentifikuar			8/433	8591	50	4500	225000	225000	Pretendon Tahir Barbullushi
10	Bajram		Guri	8/339	8591	68	4500	306000	306000	Proçes rregjistrimi
11	Abdulla		Dyli	8/353	8591	198	4500	891000	891000	Plotësim dokumentacioni
12	Lab		Kurtabegu	8/44	8591	66	4500	297000	297000	Pretendojne
13	I paidentifikuar			8/51	8591	78	4500	351000	351000	Proçes rregjistrimi
14	Fatmira		Trashani	8/39	8591	35	4500	157500	157500	Proçes rregjistrimi
15	Rauf		Mjeda	8/20	8591	33	4500	148500	148500	Proçes rregjistrimi
16	Familja		Barbullushi	8/10	8591	15	4500	67500	67500	Plotësim dokumentacioni
17	Familja		Myftiu	6/37	8591	135	4500	607500	607500	Plotësim dokumentacioni
18	I paidentifikuar			6/458	8591	352	4500	1584000	1584000	Plotësim dokumentacioni
19	Familja		Myftiu	6/167	8591	60	4500	270000	270000	Plotësim dokumentacioni
20	Familja		Myftiu	6/1	8591	86	4500	387000	387000	Plotësim dokumentacioni
21	Familja		Kraja	6/401,6/403	8591	260	4500	1170000	1170000	Plotësim dokumentacioni
22	Familja		Anamali	6/531	8591	192	4500	864000	864000	Plotësim dokumentacioni
23	Nazmi		Anamali	6/532	8591	192	4500	864000	864000	Plotësim dokumentacioni

24	Lulaim	Ferhati	6/234	8591	55	4500	247500	247500	Plotësim dokumentacioni
25	Kujtim	Ferhati	6/233	8591	80	4500	360000	360000	Plotësim dokumentacioni
26	Petrit	Kullolli	5/41	8591	167	4500	751500	751500	Proçes rregjistrimi
27	Faik	Kullolli	5/62	8591	328	4500	1476000	1476000	Proçes rregjistrimi
28	Fahri Ismail Ejup	Smali	5/61	8591	365	4500	1642500	1642500	Plotësim dokumentacioni
29	Familja	Hoxha	3/301	8591	14	4500	63000	63000	Proçes rregjistrimi
30	Kujtim Asllan	Ibrahimi Veseli	3/300	8591	83	4500	373500	373500	Plotësim dokumentacioni
31	Harun	Berberi	3/304	8591	260	4500	1170000	1170000	Proçes rregjistrimi
32	Riza	Hoxha	3/305	8591	297	4500	1336500	1336500	Proçes rregjistrimi
33	I pidentifikuar		3/306	8591	189	4500	850500	850500	Pretendon Qamil Ramekaj
34	Kujtim	Dehati	3/308	8591	162	4500	729000	729000	Proçes rregjistrimi
35	Lac Idriz	Gjonaj	4/28	8591	181	4500	814500	814500	Proçes rregjistrimi
36	Jakup	Kotaj	4/61	8591	228	4500	1026000	1026000	Proçes rregjistrimi
37	Xhevair	Hasa	4/10	8591	86	4500	387000	387000	Proçes rregjistrimi
38	Besnik	Demi	1/129	8591	10	4500	45000	45000	Proçes rregjistrimi
39	Gani	Bajraktari	5/59	8591	128	4500	576000	576000	Plotësim dokumentacioni
40	Bese	Saiti	4/14	8591	51	4500	229500	229500	Plotësim dokumentacioni
41	Zef	Lakaj	4/12	8591	87	4500	391500	391500	Plotësim dokumentacioni
42	I pidentifikuar		13/13	8591	39	4500	175500	175500	Plotësim dokumentacioni
43	Xheladin	Zardelia	13/14	8591	40	4500	180000	180000	Proçes rregjistrimi
44	Daut	Shkreli	13/8	8591	81	4500	364500	364500	Proçes rregjistrimi
45	Samie	Osja	13/17	8591	18	4500	81000	81000	Proçes rregjistrimi
46	I pidentifikuar		13/173	8591		4500	0	0	Plotësim dokumentacioni
47	Selim	Zerdelia	13/18	8591	117	4500	526500	526500	Proçes rregjistrimi
48	Hamza	Zerdelia	13/19	8591	49	4500	220500	220500	Proçes rregjistrimi
49	Skender	Liqeni	13/117	8591	58	4500	261000	261000	Proçes rregjistrimi
50	Riza	Liqeni	13/116	8591	21	4500	94500	94500	Proçes rregjistrimi
51	Qemal	Liqeni	13/115	8591	27	4500	121500	121500	Proçes rregjistrimi
52	Enver	Kraja	13/251	8591	60	4500	270000	270000	Proçes rregjistrimi
53	I pidentifikuar		6/170	8591	39	4500	175500	175500	Plotësim dokumentacioni
54	I pidentifikuar		6/222	8591	35	4500	157500	157500	Plotësim dokumentacioni
55	Ismet	Dehati	3/309	8591	207	4500	931500	931500	Proçes rregjistrimi

56	Gramoz Muha	Kopliku Hasi	8/343	8591	72	4500	324000	324000	Proçes rregjistrimi
57	Isak Refik Fatmir Hamza	Meti	8/348	8591	27	4500	121500	121500	Plotësim dokumentacioni
58	Bajram	Meti	8/349	8591	129	4500	580500	580500	Plotësim dokumentacioni
59	I paidentifikuar	Guri	8/341	8591	28	4500	126000	126000	Proçes rregjistrimi
60			8/342	8591	24	4500	108000	108000	Plotësim dokumentacioni
	Shuma				6533		29398500	29398500	

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Rrethi Shkoder
Bashkia Shkoder

Lista e Pronareve qe shproneshohen per efekt te ndertimit te Unazes Shkoder.

Lloji I Pasurise Patundshme: Truall dhe objekte nr.(1-60)

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr.Parc	Z.Kadastrale	TRUALL			Vlera totale ne leke	Shenime
						Sip. (m2)	Cmimi L/m2	Vlefia ne leke		
1	Berhan		Kreja	7/40	8592	137	4500	616500	616500	Proces rregjistrimi
2	Zija		Peraniqi	6/209	8592	33	4500	148500	148500	Proces rregjistrimi
3	Sadedin		Durrarj	7/41	8592	112	4500	504000	504000	Proces rregjistrimi
4	Qazim		Osmani	7/96	8592	75	4500	337500	337500	Proces rregjistrimi
5	Osman		Deltina	7/83	8592	45	4500	202500	202500	Plotësim dokumentacioni
6	Beqir		Beqiri	7/82	8592	9	4500	40500	40500	Proces rregjistrimi
7	Smail		Shyti	7/79	8592	42	4500	189000	189000	Plotësim dokumentacioni
8	I paidentifikuar			6/245	8592	150	4500	675000	675000	Pretendon Rifat Tarlani
9	Lirije Kujtim		Bajrami Selhani	7/404	8592	101	4500	454500	454500	Plotësim dokumentacioni
10	Servet		Kali	6/133	8592	66	4500	297000	297000	Proces rregjistrimi
11	Hajrullah		Murici	7/395	8592	19	4500	85500	85500	Proces rregjistrimi
12	Hysni		Plezha	7/396	8592	41	4500	184500	184500	Proces rregjistrimi
13	Shyqyri		Dashi	7/375	8592	6	4500	27000	27000	Proces rregjistrimi
14	Bajram		Haxhia	6/129	8592	496	4500	2232000	2232000	Proces rregjistrimi
15	Fatmir		Haxhia	6/132	8592	51	4500	229500	229500	Proces rregjistrimi
16	Sabah		Jakupi	6/128	8592	54	4500	243000	243000	Proces rregjistrimi
17	Ymer		Halluni	6/127	8592	58	4500	261000	261000	Proces rregjistrimi
18	Arben		Halluni	6/124	8592	13	4500	58500	58500	Proces rregjistrimi
19	Hajri		Cela	6/116	8592	18	4500	81000	81000	Proces rregjistrimi
20	Isa		Llampiri	6/112	8592	54	4500	243000	243000	Proces rregjistrimi

21	I paidentifikuar			6/110	8592	55	4500	247500	247500	Plotësim dokumentacioni
22	Petrit		Habovija	6/96	8592	5	4500	22500	22500	Plotësim dokumentacioni
23	Latif		Vyshta	6/95	8592	31	4500	139500	139500	Plotësim dokumentacioni
24	Xhevat		Gjatoja	6/76	8592	63	4500	283500	283500	Plotësim dokumentacioni
25	Ruzhdi		Gjatoja	6/77	8592	135	4500	607500	607500	Plotësim dokumentacioni
26	Medo		Gjatoja	5/461	8592	63	4500	283500	283500	Plotësim dokumentacioni
27	Fadil		Xhepa	6/40	8592	120	4500	540000	540000	Proçes rregjistrimi
28	Brahim		Lusha	6/28	8592	88	4500	396000	396000	Plotësim dokumentacioni
29	Tahir		Vuca	6/32	8592	132	4500	594000	594000	Proçes rregjistrimi
30	Ali		Zjarri	5/87	8592	35	4500	157500	157500	Plotësim dokumentacioni
31	Skender		Alla	5/83	8592	63	4500	283500	283500	Plotësim dokumentacioni
32	Rustem		Driraj	5/82:5/262	8592	99	4500	445500	445500	Plotësim dokumentacioni
33	Smail		Gjorreta	5/81	8592	120	4500	540000	540000	Proçes rregjistrimi
34	Glyze		Curri	5/114	8592	153	4500	688500	688500	Proçes rregjistrimi
35	Brahim		Alushi	5/46	8592	123	4500	553500	553500	Proçes rregjistrimi
36	Ali									
37	Xhavit		Fregja	5/43:5/44	8592	108	4500	486000	486000	Proçes rregjistrimi
38	I paidentifikuar			5/95	8592	162	4500	729000	729000	Pretndon Alfred Mehmeti
39	Adnan		Nikshiqi	5/8	8592	57	4500	256500	256500	Proçes rregjistrimi
40	Ramiz		Qyttyli	5/7	8592	120	4500	540000	540000	Proçes rregjistrimi
41	Berhan Gani		Bishanaku	5/52	8592	135	4500	607500	607500	Plotësim dokumentacioni
42	Xhamia		Kiras	5/2	8592	60	4500	270000	270000	Proçes rregjistrimi
43	I paidentifikuar			7/87	8592	36	4500	162000	162000	Plotësim dokumentacioni
44	I paidentifikuar			7/86	8592	15	4500	67500	67500	Plotësim dokumentacioni
45	Familja		Beqiri	7/80	8592	34	4500	153000	153000	Plotësim dokumentacioni
46	Qazim		Driraj	5/116	8592	60	4500	270000	270000	Plotësim dokumentacioni
47	Shyqyri		Brahimi	5/455	8592	99	4500	445500	445500	Plotësim dokumentacioni
48	I paidentifikuar			5/93	8592	36	4500	162000	162000	Plotësim dokumentacioni
49	Qamil		Dangu	5/75	8592	14	4500	63000	63000	Plotësim dokumentacioni
50	I paidentifikuar			5/46	8592	129	4500	580500	580500	Plotësim dokumentacioni
51	I paidentifikuar			5/89	8592	65	4500	292500	292500	Plotësim dokumentacioni
52	Teofik		Pirani	5/217	8592	33	4500	148500	148500	Plotësim dokumentacioni
53	Ali		Zmijani	6/31	8592	48	4500	216000	216000	Plotësim dokumentacioni
54	I paidentifikuar			6/228	8592	85	4500	382500	382500	Plotësim dokumentacioni
55	Smail		Shyti	7/77:7/79	8592	21	4500	94500	94500	Plotësim dokumentacioni
56	Kujtim		Selhani	7/403	8592	22	4500	99000	99000	Plotësim dokumentacioni

56	Mehmet	Selhani	6/211	8592	15	4500	67500	67500	Plotesim dokumentacioni
57	Familja	Gerqari	6/221	8592	26	4500	117000	117000	Proces rregjistrimi
58	Familja	Pirovici	6/208	8592	26	4500	117000	117000	Plotesim dokumentacioni
59	Familja	Gerqari	6/247	8592	24	4500	108000	108000	Proces rregjistrimi
60	Bahri	Ramo	7/4	8592	18	4500	81000	81000	Plotesim dokumentacioni
	Shuma				4313		19408500	19408500	

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 24.6.2007
Doli nga shtypi më 27.6.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 20 lekë